



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Primiye/Prodato Received/Delivery	17. 11. 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ/Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Saala Kolicina Quantity
SKANSHCK	7200/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.807/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.807/2022 të datës 20.09.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë banimi në [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit Komuna e Klinës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.807/2022 e datës 20.09.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

II. Shfuqizohet Vendimi me numër 02 Nr.110-30572/222 i datës 19.08.2022 i Komisionit të Pranimit, faza e vlerësimit përfshirë testimin me shkrim, jetëshkrimin dhe intervistën me gojë lidhur me konkursin për pranim me numër reference RN00009269 të shpallur me datë 11.07.2022 nga Komuna e Komunën e Klinës për grupin "Specialist të Shkencave Shoqërore"- për pozitën "Zyrtar për Biblioteka 1".

III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit të ndërmer të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi ashtu që procedura e rekrutimit me numër referencë RN00009269 të vazhdoj nga faza e verifikimit paraprak në pajtim me pikëpajet juridike sipas këtij vendimi dhe dispozitat ligjore ne fuqi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Komuna e Klinës, sipas njoftimit të datës 20.06.2022 ka shpallur konkursin me numër reference RN00009269 për grupin "Specialist të Shkencave Shoqërore" për pozitën "Zyrtar për Biblioteka 1", me afatin për aplikim nga data 11.07.2022 deri me datë 19.07.2022, duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 34 (2 dhe 3) të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 nenet 7 dhe 9. për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesja [redacted] ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Komuna e Klinës, i publikuar sipas njoftimit të datës 20.06.2022 për grupin „Specialist të Shkencave Shoqërore” për pozitën "Zyrtar për Biblioteka 1", në Komunën e Klinës, në të cilën procedurë ankuesja ka qenë e përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit, ndërsa me datën 15.08.2022 Zyra e Personelit pranë Komunës së Klinës ka publikuar Njoftimin me numër të protokollit 111-29619 lidhur me kandidatin e suksesshëm, ku ankuesja ishte e renditur në vendin e dytë me 84.60 pikë.

E pa kënaqur me rezultatin e datës 15.08.2022, ankuesja me datën 17.08.2022 ka parashtruar ankesën me numër 02-111-30018/2022, tek Zyra e Personelit me pretendimin ankimore se i është bërë padrejtësi në vlerësimin e jetëshkrimit /CV-së si dhe në vlerësimin e intervistës me gojë. Ndërsa me datën 19.08.2022 Komisioni për pranim ka marr vendimin me numër 02.Nr.110-03572/22 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar duke e lënë në fuqi Njoftimin e datës 15.08.2022 për kandidatin e suksesshëm, si dhe duke e sqaruar se vlerësimi i Jetëshkrimit është i drejtë duke e vlerësuar ankuesen me 7 pikë në Edukim, 6 pikë tek përvoja e punës (pasi që përvoja e punës nuk është domethënëse në vendin e kërkuar të punës) si dhe tek trajnimet 2 pikë (pasi që nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse për pozitën e punës), ndërsa tek pretendimi lidhur me vlerësimin e intervistës me gojë komisioni ka sqaruar se ankuesja është vlerësuar me 4.6 pikë nga pesë pyetjet e përgatitura për intervistë në pyetjen 1, 2, 4 dhe 5 ankuesja ka dhënë përgjigje pjesërisht të sakta ndërsa në pyetjen e 3 nuk është përgjigjur fare, duke e udhëzuar ankuesen për të drejtën e ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, brenda afatit ligjor.

Ankuesja e pakënaqur me vendimin me numër 02. Nr.110-30572/22 të datës 19.08.2022 të Komisionit të Pranimit lidhur me refuzimin e ankesës së datës 17.08.2022, përmes Postës së Kosovës me datën 16.09.2022 ka parashtruar ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e cila në Këshill është regjistruar me numër të protokollit 5508/2022 me datën 20.09.2022, me pretendimet ankimore shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit për Zyrtar Publik dhe Rregullores për Pranim dhe Karriera në Shërbim Civil të Kosovës Nr.16/2020, vlerësim jo i drejte i CV-së dhe përgjigje të dhëna në pyetjet e parashtruara gjatë intervistës nga Komisioni i Pranimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.09.2022, ka proceduar kërkesën për

përgjigje në ankesë të ankueses tek Komuna e Klinës. Ndërsa Këshilli me datë 03.10.2022 ka pranua nga Komuna e Klinës përgjigjen në ankesë me numër protokollit 5811/2022 me shkresat e bashkangjitura lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Bazuar në kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, Kryetari i Këshillit të Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.11.2022 ka nxjerr Vendim VK.nr.140/2022 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosje për dhjetë ditë pune lidhur me ankesën e ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5508/2022 të datës 20.09.2022, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00009269 të datës 20.06.2022; Njoftimin me numër të Protokollit 111-29619/2022 të datës 15.08.2022; Ankesën me numër të protokollit 02-111-30018/2022 të datës 17.08.2022 të parashtruar nga ankuesja në Zyrën e Personelit në Komunën e Klinës; Vendimin me numër 02.Nr.110-30572/22 të datës 19.08.2022; Emalin e datës 19.08.2022 të SMBNJ-së drejtuar ankueses; Emalin e datës 22.08.2022 të drejtuar ankueses; Njoftimin me numër të protokollit 111-30663 të datës 22.08.2022; Rezultatet e vlerësimit të verifikimit paraprak të datës 06.09.2021 për pozitën "Specialist i Ekonomisë"; Rezultatet e vlerësimit paraprak të datës 21.09.2021 për pozitën "Specialist të Përgjithshëm të tatimit-I"; Rezultatet e verifikimit paraprak për pozitën "Specialist të Buxhetit"; Rezultatet e vlerësimit të datës 15.08.2022 për pozitën "Specialist i Shkencave Shoqërore"; Njoftimin me numër të protokollit 111-44007/2021 të datës 14.12.2021; Njoftimin me numër të protokollit 111-45362/2021 të datës 28.12.2021; Njoftimin me numër të protokollit 112-10723/2022 të datës 05.04.2022; Diplomën me Nr.552 të datës 10.05.2019 me të cilën dëshmohet se ankuesja ka përfunduar studimet me datën 06.05.2019 me të cilën mori titullin Master i arteve në Kontabilitet dhe Financa; Diplomën me Nr.0888 të datës 08.07.2015 me të cilën dëshmohet se ankuesja ka përfunduar studimet me datën 21.10.2014 dhe mori titullin Bachelor i Shkencave Administrim dhe Biznes; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5580/2022 të datës 21.09.2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 5811/2022 të datës 03.10.2022; Testi individual i datës 05.08.2022 i ankueses; Testi individual i datës 05.08.2022 i kandidatit (si kandidati me i suksesshëm); Kërkesën për fillimin procedurës së rekrutimit në praninë jashtëm për pozitën Zyrtar për Biblioteka1: Vendimin me numër të Protokollit 112/46117/11 të datës 30.12.2021 lidhur me formimin e komisionit për vlerësim; Njoftimin e datës 20.07.2022 lidhur me verifikimin paraprak; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 15.08.2022; Emalin e datës 25.10.2022 të Zyrtares së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës drejtuar Burimeve Njerëzore në Komunë të Klinës; Emalin e datës 26.10.2022 të Burimeve Njerëzore në Komunën e Klinës drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës.; Emalin e datës 04.11.2022 të drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Akt Emërimit me Nr.112-7671/2022 të datës 08.03.2022 të Ndryshim dhe plotësimin e akt emërimit me Nr.120-1436/13 të datës 01.03.2013 të Aplikacionin e datës 14.07.2022 të ankesës; Vërtetimin me numër 02. Nr.152-1481/21 të datës 14.01.2021; Vërtetimin me numër 02-Nr.152-37599/19 të datës 02.09.2019; Dokumentin e identifikimit të ankueses; Pasqyra e llogaris Trusti për periudhën 17.07.2012 deri me datën 23.02.2022; Certifikatën e datës 01.03.2022 nga evidenca personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave

te dënuar nga kjo gjykatë; Referencën e datës 18.08.2021; Referencën e datës 01.03.2022; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit te kompjuterëve për tre muaj; Certifikatën e datës 18.06.2022 lidhur me përfundimin e kursit te gjuhës angleze; Certifikatën me numër 41/2088;; aplikacionin e datës 18.07.2022 te kandidatit të përzgjedhur; Vërtetimin me numër 02.Nr.112-24054/20225 të datës 13.07.2022; Pasqyrën e llogarisë Trusti i ankuesit për periudhën 01.01.208 deri me datën 13.07.2022; Dokumentin e identifikimit te ankuesit; Certifikatën e datës 12.07.2022 nga evidenca personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe peronave të dënuar nga kjo gjykatë; Akt emërimin e [redacted] me numër 02-112-6409/19 të datës 29.09.2018; Ndryshim dhe Plotësimin e akt emërimit me numër 122-1492/22 të datës 11.01.2022; Akt emërimin me numër 112-2771/11 të datës 01.08.2011 të [redacted] Akt emërimi me numër 112-6224/18 të datës 20.08.2018; Akt emërimin me numër 112-2900/11 të datës 01.08.2011 të [redacted] Marrëveshjen me numër 112-38710/21 të datës 26.10.2021; Ndryshim dhe Plotësimin e akt emërimit me numër 112-4721/13 të datës 01.12.2013 të [redacted] Diplomën e datës 20.05.2021 te [redacted] me të cilën dëshmohet se ka përfunduar temën e doktoratës në drejtimin Histori; Akt emërimin me numër 122-48424/11 të datës 26.11.2019 të [redacted] Emalin e datës 26.10.2022 të [redacted] drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës ; Emalin e datës 25.10.2022 të Këshillit drejtuar [redacted]

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit, në bazë të vlerësimit te provave, ka konstatuar se sipas konkursit me numër reference RN00009269, për grupin e punës "Specialist të Shkencave Shoqërore" si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: *Arsimi: Diplomë/a të studimeve universitare të drejtimeve: Ekonomik (pa specifikime), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë sociale, me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, Përvoja e punës; Nuk kërkohet".*

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ndër të tjera pretendon se Komisioni i Pranimit është themeluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi sepse në komisionin e vlerësimit asnjëri nga anëtarët nuk ka qenë nga Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore ashtu siç është e parapare në Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të pretendimit të ankueses lidhur me komisionin e pranimit ka konstatuar se sipas Vendimit me numër 02 Nr.112-46117/21 të datës 30.12.2022, për themelimin e Komisionit për vlerësimin për konkursin pranim, ka gjetur se në këtë vendim nuk janë përshkruar pozitat e anëtarëve të këtij komisioni si dhe zëvendësuesve, rrjedhimisht për të vlerësuar këtë pretendim më datë 25.10.2022 kemi kërkuar informata zyrtare nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Klinës nëse ndonjë nga anëtarët e këtij komisioni janë nga kjo njësi, ndërsa sipas e-mailit të datës 26.10.2022 të përcjell nga zyrtari i Personelit të Komunës së Klinës është konfirmuar se asnjëri nga anëtarët e Komisionit të Pranimit nuk janë nga Njësia e Burimeve Njerëzor. Bazuar në këtë fakt Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni i Pranimit është emëruar në kundërshtim me nenin 18 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin është përcaktuar se: "Komisioni i Pranimit në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni përbëhet nga: 2.1. një (1) anëtar nga Njësia



Përgjegjëse, i cili kryeson komisionin; si dhe në kundërshtim me nenin 34 paragrafit 12 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: "Komisioni i pranimit përbëhet nga të paktën 5 persona, me këtë përbërje: një (1) përfaqësues nga Njësia përgjegjëse; tre (3) nëpunës civilë të nivelit të mesëm apo të ulët, drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi, dhe një (1) ekspert i jashtëm në procesin e përzgjedhjes nga organizata të specializuara apo universitetet. Në cilësinë e vëzhguesve një nga sindikata dhe një nga shoqëria civile. Prandaj Kolegji vlerëson se pretendimi i ankueses është i bazuar.

Bazuar në rrethanat si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se nuk mund të vazhdohet një procedurë pranimi përderisa komisioni i pranimit është në kundërshtim me frymën e normës juridike, rrjedhimisht Kryetari i Komunës së Klinës, në pajtim me këtë vendim është i obliguar që të bëjë themelimin e komisionit të pranimit në frymën e legjislacionit në fuqi. Si rezultat i kësaj Kolegji i Këshillit, vlerëson se çdo veprim i ndërmarr nga Komisioni i Pranimit sipas Vendimit me numër 02 Nr.112-46117/21 i datës 30.12.2021 është i kundërligjshëm, kështu që për mos t'u anuluar procedura në tersi, pas veprimeve të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, atëherë të vazhdohet me procedurën e pranimit për grupin "Specialist të Shkencave Shoqërore" për pozitën "Zyrtar për Biblioteka 1", nga testimi me shkrim deri në përzgjedhjen e kandidatit fitues dhe këtë ta bëjë në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi.

Nga ato që u thanë më lartë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda.A.nr.807/2022.

Ilire Mehmeti-SHAQIRI

Procesmbajtëse

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Klinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Klinës dhe
- Arkivit të KPMShCK- së.

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit